

VENDIM
Nr. 824, datë 7.10.2015

**PËR KRIJIMIN, ADMINISTRIMIN DHE PËRDORIMIN E SISTEMIT
ELEKTRONIK PËR REGJISTRIMIN DHE GJURMIMIN E TË DHËNAVE MBI
RASTET E KORRUPSIONIT DHE STATISTIKAVE TË HARMONIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin, funksionimin dhe administrimin e Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara, në formatin *web-based*.

2. Baza e të dhënave të Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara ngrihet, administrohet dhe përditësohet pranë ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, si Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit dhe institucioni administrues, në kuptim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

3. Sistemi Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara ngrihet për:

- a) mbledhjen e të dhënave dhe harmonizimin e statistikave të rasteve të korrupsionit në kohë reale, nëpërmjet gjurmimit të të dhënave të ndjekjes penale dhe procedurave gjyqësore;
- b) lehtësimin e veprimtarisë së Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit në monitorimin dhe analizën e të dhënave të mbledhura për rastet e korrupsionit;
- c) përmirësimin e cilësisë së statistikave të harmonizuara, të gjeneruara nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit;

ç) unifikimin dhe kompjuterizimin e të dhënave për rastet e korrupsionit.

4. Sistemi Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara, si bazë të dhënash shtetërore, hostohet në serverët e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

5. Dhënës të informacionit në Sistemin Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara janë institucionet shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, si dhe institucionet e tyre të varësisë, si më poshtë vijon:

- a) Kryeministria;
- b) Të gjitha ministritë;
- c) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- ç) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- d) Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- dh) Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;
- ë) Agjencia e Prokurimit Publik;
- ë) NJKBA-ja, njësia antikorrupsion, pranë Kryeministrit;
- f) Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat;
- g) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe të gjitha drejtoritë rajonale të Policisë.

6. Dhënësit e informacionit, të cilët janë institucione kushtetuese të pavarura, përfshirë, por pa u kufizuar te prokuroritë, Prokuroria e Përgjithshme, Gjykata e Lartë, bashkëpunojnë, në bazë të marrëveshjeve të ndërsjella, për hedhjen e të dhënave, lidhur me veprimtarinë e tyre në kuadër të qëllimit të Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara, sipas pikës 3, të këtij vendimi.

7. Sistemi Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara përmban të dhëna parësore, të përditësuara, për:

a) njoftimet dhe kallëzimet e kryera pranë organeve të ndjekjes penale nga institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor, si dhe institucionet e tyre të varësisë, në zbatim të pikës 5, të këtij vendimi, për një veprë penale të dyshuar korrupsionit të ndodhur në atë institucion: datën e kallëzimit; prokurorinë ku bëhet kallëzimi; numrin dhe pozicionin e të kallëzuarve; veprën penale të korrupsionit të dyshuar;

b) marrëveshjet e bashkëpunimit dhe dakordësinë ndërinstitucionale, të dhëna për ndjekjen penale të ushtruar nga prokuroritë për veprat penale të korrupsionit, sipas këtyre marrëveshjeve, në zbatim të pikës 6, të këtij vendimi;

c) veprat penale të korrupsionit, të marra nga gjykata, në zbatim të pikës 5, të këtij vendimi; të dhënat mbi akuzën e ngritur nga prokuroria; datën dhe numrin e regjistrimit të çështjes; llojin e gjykimit; vendimin e gjykatës; numrin dhe pozicionin e personave të dënuar, nëse ka; llojin e dënimit;

ç) të dhëna që merren nga institucionet e pavarura kushtetuese, në zbatim të pikës 6, të këtij vendimi, sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe dakordësisë ndërinstitucionale.

8. Sistemi Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara nuk përmban të dhëna personale, për veprat penale të korrupsionit, në kuptim të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

9. Çdo përdorues i Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara, pajiset, nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, me emrin e përdoruesit, “*user name*”, fjalëkalimin, “*password*”, dhe me manualin për hedhjen e të dhënave në sistem, operimin dhe përdorimin e faqes web.

10. Me qëllim grumbullimin e të dhënave në Sistemin Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara, brenda njëzet e katër orëve, nga momenti i krijimit të informacionit të kërkuar, sipas këtij vendimi, përdoruesit plotësojnë në formë elektronike, nëpërmjet llogarisë së tyre në sistem dhe personave të autorizuar rregullisht, për këtë qëllim, të dhënat përkatëse.

11. Institucionet e varësisë dhe/ose drejtoritë rajonale të institucioneve, të cilët nuk kanë akses të drejtpërdrejtë në sistem, sigurojnë që informacioni t’i dërgohet organit epror të menjëhershëm, i cili ka llogari në sistem. Organi epror, nëpërmjet llogarisë së tij, plotëson sistemin në emër të institucionit që ka dërguar të dhënat. Institucionet e varësisë dhe/ose drejtoritë rajonale dhe institucionet eprore marrin të gjitha masat që komunikimi i të dhënave mes tyre dhe hedhja e të dhënave në sistem të përfundojë brenda njëzet e katër orëve, nga momenti i krijimit të informacionit nga institucioni dërgues.

12. Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit ka detyrë:

a) të vendosë në dispozicion të organeve shtetërore përdoruese të sistemit programin e sistemit për hedhjen e të dhënave në formatin “*web-based*”;

b) të bashkëpunojë dhe bashkërendojë punën me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për hostimin e sistemit;

c) të mbikëqyrë dhe ofrojë asistencë teknike për përdorimin e sistemit, mbledhjen e kallëzimeve dhe të dhënave të tjera në sistem nga institucionet shtetërore, subjekt i këtij vendimi;

ç) të vendosë në dispozicion të organeve shtetërore mundësinë e gjenerimit automatik të statistikave nga sistemi, për të dhënat e hedhura nga secili institucion;

d) të trajnojë përdoruesit e sistemit në lidhje me raportimin, hedhjen e të dhënave dhe përditësimin e tyre si dhe për administrimin e përshtatshëm të sistemit, sipas qëllimit të përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi;

dh) të propozojë masa për rritjen e efikasitetit të sistemit dhe përmirësimin e tij në të ardhmen.

13. Dhënësit e informacionit në Sistemin Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara kanë akses të hapur dhe pa pagesë për përdorimin, printimin dhe përpunimin e të dhënave të hedhura në llogarinë e tyre në sistem. Statistikat e harmonizuara, të gjeneruara nga sistemi, në bazë të të dhënave të hedhura nga të

gjithë përdoruesit, u vihen në dispozicion përdoruesve nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, sipas afateve dhe mënyrave të përcaktuara në Manualin e Përdorimit të Sistemit.

14. Të gjithë përdoruesit janë përgjegjës për saktësinë dhe koherencën e të dhënave të hedhura nëpërmjet llogarisë së tyre në Sistemin Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara.

15. Rregullorja e përdorimit të Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara dhe niveli i aksesit për përdoruesit përcaktohen në Manualin e Përdorimit të Sistemit, të miratuar nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit.

16. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), si Autoriteti Rregullator Koordinues i Bazave të të Dhënave Shtetërore, garanton funksionimin, në mënyrë të vazhdueshme, të Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara, mbrojtjen nga viruset e sulmet e ndryshme të kësaj faqeje dhe informacionit që gjendet në të, kryerjen periodike të *back-up*-it etj. AKSHI, sipas nevojave, përgjigjet për zhvillimin periodik të Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara.

17. Përdorimi i Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara fillon nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

18. Ngarkohen institucionet shtetërore të hedhin të dhënat që disponojnë, duke filluar nga viti 2014, me qëllim përditësimin e këtij sistemi.

19. Ngarkohen Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, institucionet shtetërore të listuara në pikën 5, të këtij vendimi, dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
EDI RAMA